



Pranuar / Dorezuar Punë/Procedura Recv./Delivery	15-06-2022	viti god. year	2
Organ /Bësitë Organ /Institucio Org./Unit	SI/PR/KCV	Siç është shprehur As per Expr.	Sasia Kufizuar Quantity
	3512/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova -- Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.448/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga:** Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.448/2022 të datës 12.05.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi rruga [redacted] në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.06.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.448/2022 e datës 12.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]**

**II. OBLIGHET** Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, që ankuesit [redacted] ti realizohet kompensimi i pagës sipas Akt emërimit me numër 1871, të datës 28.12.2018 me koeficient gjashtë pikë pesë (6.5) dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca prej 0.5 e koeficientit duke filluar nga data 21.04.2022 e deri në zbatim të këtij vendimi.

**III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.**

## A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] është i punësuar në Agjencinë e Punësimit sipas Akt emërimit me numër 28.12.2018, në pozitën "Zyrtar për shërbime të punësimit në Zyrën e Punësimit në Klinikë.

Me datën 21.04.2022, ankuesi ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 29, tek Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit në listën e pagave sipas akt emërimit. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, me datën 22.04.2022 e ka refuzuar kërkesën e ankuesit.

I pakënaqur me mos harmonizimin e pagës konform akt emërimit, ankuesi fizikisht me datën 12.05.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2749/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se i njëjti edhe pse mban akt emërimin me koeficient 6.5 paguhet sipas koeficientit 6, i njëjti kërkon nga Këshilli që ti aprovoj ankesën dhe ta obligoj Ministrinë e Financave ti paguaj pagën sipas koeficientit 6.5 dhe t'ia paguaj në mënyrë retroaktive ndryshimin e pagesës që nga muaji prill i vitit 2015.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:2749/2022 të datës 12.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 21.04.2022 nga ankuesi lidhur me harmonizimin e koeficientit sipas akt emërimit; Akt emërimin e ankuesit me numër 70 të datës 28.12.2017; Akt emërimin e ankuesit me numër 104 të datës 28.12.2017 11.03.2015; Shkresën zyrtare të datës 05.02.2018 për gjendjen e llogarisë së ankuesit; Shkresën zyrtare të datës 03.08.2016 për gjendjen e llogarisë së ankuesit; Kërkesën e datës 19.02.2015 me numër 235 lidhur me avancimin e pozitës së ankuesit; Listën e pagës për muajin shkurt të vitit 2022 për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 20.05.2022 nga Agjencia e Punësimit; E-mailat zyrtar të datës 19.05.2022; Akt emërimin e ankuesit me numër 94 të datës 21.02.2014; Akt emërimin e ankuesit me numër 773 të datës 08.06.2012; Kontratën e marrëdhënies së punës të ankuesit me numër 03 të datës 10.01.2011; Përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit për pozitën zyrtar për shërbime të punësimit; Refuzimin në kërkesën e ankuesit të datës 22.04.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës; Listën e pagave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2020,2021 dhe muajt shkurt, mars dhe prill të vitit 2022; Akt emërimin me numër 275 të datës 10.04.2019; Diplomën e ankuesit me numër 2033 e datës 14.04.2012; Akt emërimin me numër 137 të datës 28.12.2017; Certifikatën e datës 27.03.2008; Akt emërimin me numër 110 të datës 28.12.2017; Certifikatën e datës 29.09.1997.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së është **pjesërisht e bazuar** ankesa e ankuesit

**SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar dëshmitë në shkresat e lëndës së ankuesit, konstatoi se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me atë se paga

duhet të realizohet konform akt emërimit, janë të bazuara në dispozitat e legjislacionit në fuqi të shërbimit civil, respektivisht në pajtim me nenin 3 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, në të cilin përcaktohet se: *"Institucionet e administratës publike te Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punë të njëjtë"*, pastaj nenin 8 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, ku precizohet se: *"Paga bazë e nëpunësit civil llogaritet duke shumëzuar koeficientin me vlerën e koeficientit"*. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave po ashtu lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar edhe dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenin 9 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunëseve Civil, ku është përcaktuar se: *"Nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin pagën për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës"*, andaj në kuptim të këtyre dispozitave si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi ushtron pozitën si "Zyrtar për shërbime të punësimit" në Agjencinë e Punësimit-Zyra e punësimit në Klinë sipas Akt emërimit me numër 70 të datës 28.12.2018 me koeficient gjashtë pikë pesë (6.5), Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 28.12.2018 dhe si rrjedhojë pas analizimit të provave të lëndës së ankuesit në bazë të dëshmisë së listës së pagave del se i njëjti paguhet me koeficientin gjashtë (6) e jo gjashtë pikë pesë (6.5) sipas akt emërimit me numër 1871, të datës 28.12.2018.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili kërkon kompensimin për njohje retroaktive që nga data 11.03.2015 sipas Akt emërimit me numër 104 si dhe sipas Akt emërimit me numër 70 të datës 28.12.2017, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se në bazë të shkresave të lëndës nuk kemi dëshmi se i njëjti për këtë periudhë kohore, ka ndërmarrë veprime ligjore lidhur me realizimin e kësaj të drejte, andaj duke u nisur nga fakti se ankuesi kërkesën për realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 11.03.2015 e ka parashtruar pranë organit të punësimit me datën 21.04.2022, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit përkitazi me këtë pretendim është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, prandaj edhe pretendimi i ankuesit në këtë drejtim është i pa bazuar. Andaj meqenëse ankuesi deri në periudhën e datës 21.04.2022, nuk ka ndërmarrë veprime ligjore lidhur me realizimin e kësaj të drejte, njohja e pagës për koeficientin prej gjashtë pikë pesë (6.5) i njihet sipas Akt emërimit me numër 70 të datës 28.12.2018 pra si akt emërim i fundit i ankuesit.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që ankuesit ti realizojë pagën sipas Akt emërimit me numër 70 të datës 28.12.2018, për pozitën përkatëse dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit prej 0.5 duke filluar nga data 21.04.2022, gjegjësisht nga data e parashtrimit të kërkesës pranë Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të këtij institucioni.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.448/2022, datë 15.06.2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë e Punësimit ;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK- së.

